

NJOFTIM PUNE

BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6'000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

Spar Albania sh.p.k. është pjesë e Balfin Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit "SPAR".

Pozicioni: Specialist Porosie

Departamenti: Logjistikë

Vendodhja: Tiranë

Roli: Specialisti i porosisë është përgjegjës për bërjen e porosisë tek furnitorët gjithmonë kjo në varësi të nivelit të stokut të magazinës qendrore. Nëpërmjet këtij procesi ai shmang mungesën e artikujve në magazinë dhe rrjedhimisht edhe në dyqane.

Detyra dhe Përgjegjësi:

- Mbajtja e stokut në nivele optimale bazuar në strategjine e stokut ose parametrave të përcaktuara nga kompania për menaxhimin e tij.
- Menaxhimi i niveleve të stokut dhe sasisë së artikujve të porositur tek furnitorët realizohet në bazë të nivelit të stokut aktual dhe nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme të Menaxherit të Kategorisë.
- Vendosija e vazhdueshme e kontaktit me furnitorët në menyre që të ketë të gjithë dokumentacionin e duhur që shoqërojnë të gjithë artikujt e porosisë.
- Përpilimi i raporteve të ndryshme ditore në lidhje me qarkullimin e artikujve në magazinë.
- Analizimin e nivelit të stokut dhe koeficientit të qarkullimit të tij.
- Analizimi I porosive të kryera nga dyqanet dhe bën sugjerimet e tij në lidhje me parametrat e paracaktuara të stokut (minimale, optimale, maksimale)
- Ndjekja në mënyrë të vazhdueshme furnizimin e mallrave dhe qarkullimin e tyre në dyqane, analizon sasi të qarkulluara dhe kategoritë e tyre në secilin dyqan.
- Zbatimi i termave të paracaktuara, analizimi i sasive të kërkuara të stokut në cdo kohë në mënyrë që të plotësojmë kërkesat e dyqaneve dhe të konsumatorit.
- Përgjegjës për qarkullimin e stokut në bazë të kërkesave të Departamentit të Kategorisë.

- Ndjekja dhe analiza e qarkullimit të artikujve që kanë jetëgjatësi të vogël dhe menaxhon procesin kthimit të tyre nga dyqanet, grumbullimin në magazine, kthimin tek furnitori dhe reflektimi i saktë i stokut në sistem.

Kërkesat:**a.Edukimi:**

- Preferohet të ketë kryer studimet e larta.

b.Eksperiencat e punës: Preferohet të ketë eksperiencë të mëparshme pune në profile të ngjashme.

c.Kualifikime të tjera:

Njohuri të mira të MS Office.

Njohuri të gjuhës Angleze.

d.Aftesi të tjera:

- I aftë të punojë në grup.
- Aftesi shume te mira komunikimi.

Mënyra e aplikimit*: Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV e tyre së bashku me letër motivimi në adresën e e-mailit hr@spar.al duke përcaktuar në subjekt pozicionin ose nëpërmjet postës në adresën: Spar Albania, Tirana East Gate (TEG), Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

Afati i dorëzimit: 14/06/2022

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.*